



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 150, Datë 22.07.2019

PËR MIRATIMIN E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË NJËSIVE
ORGANIZATIVE TË ADMINISTRATËS SË KLP-SË

Në mbështetje të neneve 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 189 gërma ç dhe 178 gërma ç të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” si dhe Vendimit nr.36 datë 06.03.2019” Për miratimin e strukturës organizative të administratës së KLP-së” të Këshillit të Lartë të Prokurorisë , Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e detyrave dhe përgjegjësisë për njësitë organizative të administratës dhe të pozicioneve individuale.
2. Ngarkohet administrata e KLP-së, që në zbatim të këtij vendimi të fillojë procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira në njësitë organizative të administratës së KLP-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

GENT IBRAHIMI